

VENDIM
Nr. 64, datë 12.2.2014

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË ZYRAVE, NGA DREJTORIA E
ADMINISTRIMIT DHE SHITJES SË PRONAVE PUBLIKE, NË MINISTRINË E FINANCIVE, TE
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të zyrave në katin e pestë të godinës së ish-shtëpisë botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, të cilat janë në përgjegjësi administrimi

të Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, te Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për t’u përdorur si mjedise pune nga ky institucion.

2. Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen ministri i Financave, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe kryeregjistruesi i Zyrës për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama